

PKR.nr.665/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit H.S. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të KPK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.667-4/2012, të datës 25.11.2015, pas shqyrtimit të dytë, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 31.05.2018, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Valdet Gashi dhe i akuzuari H.S., të njëjtën ditë, me datë 31.05.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H.S., me nofkën “L”, i biri i I dhe S, e vajzërisë K., i lindur me datë..., në P., lagjja “M.e.M”, rr. “S.S”, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar- baba i një fëmije, i pa punë - i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e: ka përdorur armën nën kërcënim, në atë mënyrë që me datë 23.07.2012, pas një fjalosje paraprake me të dëmtuarit B. dhe A.D., kanë nxjerr revolen e tipit “TT”, 7.62 mm, me numër serik 7-126856, dhe ua ka drejtuar të dëmtuarve si më lartë, me që rast i dëmtuari B., ka arritur t’ia kap dorën në të cilën kishte armën dhe në këtë mënyrë i pandehuri nuk ka arritur të shtijë në drejtim të tyre, e pastaj në vendin e ngjarjes policia ka gjetur veturën e të pandehurit, ndërsa afër saj ka gjetur edhe revolen me 15 fishekë të kalibrit 7.62 mm, e përdorur nga i pandehuri,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të Kodit Penal të Kosovës.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 34; 39; 60; 64; dhe 328, par. 1 dhe 5, të KPK, si dhe nenit 365 të KPPK, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në shumë prej gjashtë qind (600) €, të cilin dënim, i pandehuri **H.S.**, obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, me pëlqimin e të pandehurit gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, e nëse i dënuari nuk e jep pëlqimin gjykata do t’i caktoj një ditë burgimi për 15 € të gjobës.
- Obligohet i akuzuari që t’i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **50 €, dhe pesëdhjetë (50.00)**

€, për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

- Të akuzuarit i konfiskohet revolva “TT”, 7.62 mm, me numër serik 7-126856 dhe 15 fishekë të kalibrit 7.62 mm, e cila është përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.
- Të dëmtuarit: **A. (R.) D. dhe B.(R.) D., nga fshati L., Komuna S. dhe H. (J.) M., nga M., si dhe B. (M.) M., nga fshati G., Komuna M.,** për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.667-4/2012, të datës 25.11.2015, e ka akuzuar të pandehurin H.S., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të KPK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 24.04.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurorit i shtetit, i akuzuari H.S., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pafajshëm për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në seancën e shqyrtimit të dytë, të mbajtur me datë 31.05.2018, i akuzuari ka kërkuar fjalën dhe është deklaruar se në këtë fazë të procedurës e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se është i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, si dhe ka kërkuar nga gjykata që atij t'i shqiptoj një dënim me kusht ose me gjobë.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit, ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë pasi që më parë, ai ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe mbështetur në faktet dhe provat që përmban aktakuza, duke i propozuar gjykatës që të merr aktvendim me të cilin aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është plotësisht i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të KPK, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajit dhe sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit gjyqësor; ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me

bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimin i paraparë me nenin 34, të KPK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre dhe të përmbaj personat të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK, **kurse vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.**

Vendimi që të pandehurit t'i merret sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 328, par. 5, të KPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 01.06.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.665/15, datë 31.05.2018.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.